



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail. contact@pallatirinise.com

www.pallatirinise.com

Nr. 4/1319 Dt 21.08.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 10, paragrafit 10.5 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies me qira të hapësirave kulturore, sportive dhe ekonomike dhe kontrata e shtëpisë e dt.22.06.2023 pas identifikimit të Departamentit të Administratës për hapësirat e lira, bazuar mbi Vendimin e dt. 20.08.2025 të U.D. Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, publikohet:

**FTESË PËR OFERTË
PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE
dhe të tjera**

NPL Pallati i Rinisë sh.a., fton të gjitha subjektet e interesuara, personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm), dhe personat fizikë dhe juridik (për depo) për marrjen e hapësirave me qira për periudhë të caktuar.

Hapësirat e destinuara për persona juridikë, gjegjësisht hapësirat afariste janë si vijon:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m ²
1.	Lok. Nr.034	36 m ²	18.17 € neto
2.	Lok. Nr.046	36m ²	18.17 € neto
3.	Lok. Nr.051	425m ²	12.50 € neto
4.	Lok. Nr.073	19 m ²	18.80€ neto
5.	Lok. Nr.077	36 m ²	18.17€ neto
6.	Lok.Nr. 096	27 m ²	18.17 € neto
7.	Lok Nr.108	34 m ²	18.17€ neto
8.	Lok. Nr.035	37 m ²	18.17 € neto
9.	Zyre (ish Qendra e mjekësisë sportive)	400 m ²	15.00€ neto pjesa me ndriqim natyral 7.5 € neto pa ndriqim natyral
10.	Zyre nr. 116/6 (që ndodhet në pjesën e hollit në mes të dy sallave, niveli i sheshit, pjesa perëndimore e Sallës Universale të NPL Pallati i Rinisë sh.a.	48 m ²	7.5 €neto

Hapësirat e destinuara për persona juridik dhe fizikë janë si vijon:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m ²
1.	Depo nr.02 që ndodhet në garazhat e Qendrës Tregtare	54 m ²	6.17 € neto

2.	Depo nr. 04 që ndodhet në garazhat e Qendrës	70 m ²	6.17 € neto
3.	Depo nr. 05 që ndodhet në garazhat e Qendrës	60 m ²	6.17 € neto
4.	Depo (ish garazhë) që ndodhet në Parkingun e Qendrës	65.52 m ²	6.17 € neto
5.	Depo e sportit (përball trim kabinetit në koridorin e sallës së vogël të sportit)	83.85 m ²	6.17 € neto
6.	Depo e sportit në koridorin afër trim kabinetit	15 m ²	6.17 € neto
7.	Depo e sportit në koridoret e sallës së vogël të sportit	28 m ²	6.17 € neto

Vërejtje: Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive pasi që të njejtat janë të destinuara për sport.

AFATI I KOËZGJATJES SË KONTRATËS: Një (1) vit nga dita e lidhjes së kontratës.

Ofertuesi duhet t'i dorëzojë këto dokumente:

1. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal me informatat përcjellëse;
2. Kopjen e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të Biznesit;
3. Cmimin e ofertuar për m², i cili duhet të jetë pa TVSH (Oferta financiare);
4. Të dhënat e arkës fiskale;
5. Vërtetimin nga ATK-ja që dëshmon se biznesit është aktiv;
6. Fletëpagesën për aplikim.

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm janë:

1. Cmimi më i lartë i ofertuar se sa cmimi fillestar i përcaktuar në këtë shpallje;
2. Tarifa e aplikimit është 200€, e cila do të paguhet në këtë xhirollogari: 1708020600000056, e cila do të kompensohet me faturën e parë të qirasë. Tarifa e aplikimit nuk i kthehet ofertuesit të zgjedhur që tërhiqet nga kontrata për qira, ndërsa ofertuesit të pazgjedhur i kthehet tarifa e aplikimit.

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm duke mos ju përmbajtur kushteve kontraktuale kontratës së qirasë, përfshirë obligimet financiare ndaj Ndërmarrjes;
2. Oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara sipas kësaj shpallje;
3. Oferta arrin pas datës dhe kohës të përcaktuar për dorëzim sipas kësaj shpallje.

OFERTAT duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datë 29.08.2025 deri në orën 12:00 në zyrën e arhivës në NPL Pallati i Rinisë sh.a. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr. i hapësirës, e-maili zyrtar, nr. tel.

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit për vlerësim në prani të ofertuesve, dhjetë (10) minuta pas kohës së skadimit të dorëzimit të ofertave, gjegjësisht në orën 12:10, në zyret e Drejtorisë së NPL Pallati i Rinisë.

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat sipas kësaj shpallje, nga datë 21.08.2025 – 29.08.2025, nga ora 10:00-15:00, duke u lajmëruar tek Recepcioni i NPL Pallati i Rinisë sh.a.

Kërkesa/Aplikacioni mund të kërkohej përmes e-mailit: contact@pallatirinise.com, mund të shkarkohet në web faqen zyrtare të NPL Pallati i Rinisë sh.a. dhe mund të merret fizikisht në Recepcionin e NPL Pallati i Rinisë sh.a.